REVISTË SHKOLLORE E M.M. "ALAUDDIN" PRISHTINË

Nr. 41 / Dhjetor 2016

DRITA e نور القرآن KURANIT

www.medreseja.com

LEXIMI I KURANIT
VLERA DHE RREGULLAT

MEDRESEJA,
65 VJET EDUKIM DHE ARSIMIM PËR FE DHE ATDHE

DIJETARI ISLAM,
DR. SELMAN EL AVDE,
VIZITOI MEDRESENË

PËR RIAD EMININ


Një lajm që theu zemrat,
Atëherë kur në kokë na ra,
Shpirti na u trishtua,
Qenia na u ngurtësua,
E zemra në dysh na u nda.

Zemra të vdekura,
Në trup të nxehtë,
Që u shokuam nga kjo e vërtetë,
S'kemi fuqi as për të ecur.

Një aksident që nuk po mbaron,
Ajo përplasje që mendjet i ngurtëson,
Rrahjet zemrës ia ndaloi,
Një dhembje thellë po na torturon.

Të gjithë këtu formojmë një plotësi,
Edhe pse mbaron, tash jemi të bashkuar,
Por, fatkeqësisht, sot je duke na munguar,
Ti u largove nga kjo bashkësi.

Sara Hasani 12/4
(kushtuar ish-medresistit)



PËRMBAJTJA:

3 FJALA E KRYEREDAKTORIT
4 LEXIMI I KURANIT-VLERA DHE RREGULLAT
6 EPOKA E ARTË ISLAME
7 BLETA DHE MJALTI
8 E VËRTETA MBI TEORINË E DARVINIT
9 MEDRESEJA
10 MALL PËR PEJGAMBERIN A.S.
10 MOS U DORËZO!
10 TRËNDAFILI I ZEMRËS SIME
11 FRENIMI I ZEMËRIMIT
11 LEXO, MENDO DHE PUNO
12 LUMTURIA E SHPIRTIT - NËNA!
12 BISEDA MES MËSUESIT DHE NXËNËSIT
13 LUTJET E PEJGAMBERËVE TË ALLAHUT
14 SHFLETO TUTJE
14 DISA KËSHILLA TË HASAN EL BASRIUT RRETH MËSIMIT
15 ENGJËJT GARUAN PËR TA SHPËTUAR ATË
20 DHURATAT MË TË BUKURA
20 THËNIE
21 AKTIVITETE:
MEDRESEJA, 65 VJET EDUKIM DHE ARSIMIM PËR FE DHE ATDHE
28 KURIOZITETE
30 POEZI
31 PUNIM (MANDALLA)
32 FJALËTËRTHORE

Fjala e redaktorit

Falënderimet dhe lavdërimet i përkasin Zotit Fuqiplotë, pasi me ndihmën e Tij arritëm që pas një pune të gjatë të përfundojmë edhe numrin më të ri të kësaj reviste.

Bekimet e Allahut xh.sh. qofshin mbi të Dërguarin e Tij të fundit, Muhamedin (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të!), i cili na ka porositur që kohën ta shfrytëzojmë për vepra të dobishme, nga të cilat përfitojmë të gjithë ne.

Nga veprat e dobishme pa dyshim se konsiderohet edhe kjo revistë e nxënësve të çmuar të shkollës sonë, të cilët me punën e tyre, aktivitetet dhe angazhimin e zellshëm mundësuan që revista të marrë formën që ka tani.

"Medreseja është vendi ku parakaluan kokat më të ndritura të popullit tonë", ishte njëra ndër fjalitë e Myftiut tonë, Naim ef. Tërnava, në 65 vjetorin e Medresesë. Ndërsa drejtori Jakup ef. Çunaku tha: "Nga kjo shkollë dolën shumë kuadro të mirë, të edukuara në frymën fetare dhe kombëtare, duke mësuar si duhet respektuar dhe dashur njeriun, familjen, dhe se në çfarë mënyrë duhet të sakrifikojmë për fe e atdhe."

Pa dyshim që këto fjalë neve si nxënës na bëjnë të ndihemi krenarë që jemi pjesë e kësaj shkolle, por edhe me përgjegjësi të madhe, pasi sukseset që i dëshmoi shkolla jonë në të kaluarën duhet t'i vazhdojmë edhe ne.

Ne si gjeneratë shumë me fat dhe të privilegjuar, si gjeneratë jubilare, e 50-ta me radhë e kësaj vatre diturie, urojmë dhe lutemi që sukseset e gjeneratave vijuese të vazhdojnë dhe të jenë prijatare në atdheun tonë! Amin!

Besart Thaçi

Kryeredaktor: ***Besart Thaçi 12/4***

Redaktore: ***Valdrinë Abdullahu 12 /3***

Anëtarë të redaksisë:


Ubejd Rrustemi 12/2, Milazim Mani 12/1, Gjyltene Mavriqi 12/3, Diellza Kryeziu 12/4, Kasim Dërmaku 11/1, Adl Raci 11/2, Shpëtime Zekolli 11/5, Erza Zhushi 11/4, Dren Lipaj 10/2, Albesian Guri 10/1, Mirvete Karaliti 10/4 Hatixhe Hasani 10/5.

Lektor: **Besnik Jaha**

Dizajni: **Bashkim Mehani**

E-mail: **redaksia15@hotmail.com**
www.medreseja.com

LEXIMI I KURANIT- VLERA DHE RREGULLAT



Kjo temë është e gjerë, dhe përfshin aspekte të shumta. Prandaj, edhe dijetaret kanë shkruar shumë lidhur me këtë çështje.

Në rreshtat në vijim do të mundohem të përmend disa argumente që shfaqin vlerën e Kuranit, dhe disa rregulla që duhet të kihen parasysh gjatë leximit të tij.

A- Vlera e Kuranit

Epërsia e Kuranit ndaj fjalëve të tjera

Muhamedi a.s. ka thënë: "Epërsia e fjalëve të Allahut ndaj të gjitha fjalëve të tjera është si epërsia e Allahut ndaj krijesave të Tij."

Ai që mëson këtë libër është njeriu më i mirë

Muhamedi a.s. ka thënë: "Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin, dhe atë ua mëson të tjerëve." (Buhariu, prej Uthman bin Afanit)

Muslimi përcjell nga Ebu Musa El Eshariu, se i Dërguari i Allahut tha: "Shembulli i një besimtari që e lexon Kuranin është si i qitros: kundërmon erë të mirë, dhe ka shije të mirë. Shembulli i një besimtari që nuk e lexon Kuranin është si i hurmës: nuk kundërmon erë të mirë, por shijen e ka të ëmbël. Shembulli i një hipokriti është si i borzilokut: kundërmon erë të mirë, por shijen e ka të keqe. Shembulli i një hipokriti që nuk e lexon Kuranin është si i kastravecit të shkretëtirës: nuk ka erë, dhe shijen e ka të hidhët."

Shpërblimi i leximit të këtij libri

Tirmidhiu shënoi prej Abdullah bin Mesudit, se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Kush e lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, atij i takon një e mirë, ndërsa e mira është dhjetë sosh. Nuk them Elif, Lam, Mimë është një shkronjë, por Elifi është shkronjë, Lami është shkronjë, Mimi është shkronjë." (Buhariu)

Muslimi shënoi se Aisheja përcolli se i Dër-

guari i Allahut tha: "Ai që e lexon rrjedhshëm Kuranin, do të jetë me engjëjt fisnikë. Ai që e lexon Kuranin duke belbëzuar (me vështirësi), do të ketë dy shpërblime."

Vlera e tubimeve ku lexohet dhe mësohet Kurani

Transmeton Ebu Hurejra, se Muhamedi a.s. ka thënë: "...Njerëzit nuk takohen në ndonjërën nga shtëpitë e Allahut për ta mësuar Librin e Allahut e të mos zbresë rehatia mbi ta, të mos i mbulojë mëshira, të mos i rrethojnë engjëjt, dhe të mos ua përmend Allahu atyre që i ka pranë."

B- Rregulla që kanë të bëjnë me leximin e Kuranit.

Nijeti

Muhamedi a.s. ka thënë: "Vërtet Allahu i Madhërishëm nuk e pranon përveçse punën e cila është bërë për hir të Tij e me sinqeritet të plotë, dhe që me të është kërkuar pëlqimi i Tij." (Nesaiu, transmetuar prej Ebu Umames)

Pastrimi i gojës me misvak

Muhamedi a.s. ka thënë: "Nëse dikush nga ju është bërë gati për t'u falur natën, atëherë le ta përdorë misvakun, sepse kur dikush nga ju lexon (Kuran) në namazin e tij, engjëlli e vë gojën e tij mbi gojën e atij: çdo gjë që del nga goja e tij hyn në gojën e engjëllit." (Bejhekiu, transmetuar prej Xhabirit)

Leximi duhet të jetë i rrjedhshëm, i ngadalshëm dhe qartë

Allahu në Kuran thotë: " ...dhe lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë." (Muzzemil, 4)

Zbukurimi i zërit me lexim

Muhamedi a.s. ka thënë: "Stolisni Kuranin me zërin tuaj, se zëri i bukur Kuranit ia shton bukurinë." (Ebu Davudi, si dhe të tjerë. Transmetuar prej Berraut).


Përsiatja dhe meditimi.

Allahu në Kuran thotë: "Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin, apo i kanë zemrat të kyçura?!" (Muhamed, 24)

Këto ishin disa nga vlerat dhe rregullat që kanë të bëjnë me leximin e Kuranit. Kanë mbetur edhe shumë të tjera pa i përmendur, por shpresoj që kjo që u përmend do të na vetëdijesojë rreth këtij libri, si dhe do të na bëjë të zellshëm në leximin, mësimin dhe praktikimin e mësimeve të tij!

Allahu na e mundësoftë ta lexojmë dhe praktikojmë Kuranin ashtu siç Ai dëshiron dhe është i kënaqur!

Abdurrahman Rama 11/3



STILI I JETËS SIPAS TË DËRGUARIT (Paqja e Zotit qoftë mbi të!)

-Fol but
-Ec me përulësi!
-Ha me ndjeshmëri!
-Fli mjaftueshëm!
-Vishu mirë!
-Bashkëvepro me edukatë!
-Vepro drejt!
-Puno me durim!
-Mendo me vërtetësi!
-Bisedo me korrektësi!
-Sillu me modesti!
-Mëso praktikisht!
-Planifiko me përpikëri!
-Fito ndershëm!
-Shpenzo mençur!
-Sakrifiko rregullisht!
-Adhuro me devotshmëri!
-Shërbeju prindërve e i lumtur!
-Respekto fqinjët në mënyrë të përshtatshme!

Valdrinë Abdullahu 12/3

Epoka e artë islame

Civilizimi islam zhvillimin më të madh e pati mes shekujve VIII dhe XV. Në këtë periudhë ai lulëzoi, dhe në vete përfshiu shkencëtarët më produktivë të kohës, të cilët nuk ishin të gjithë arabë, por edhe nga jomyslimanët që vepronin nën ombrellën e civilizimit islam në territoret islame. Kjo tregon për të arriturat e mëdha që kishin bërë myslimanët në atë kohë.

Shkencëtarët myslimanë filluan të studionin fushat dhe shkencat e ndryshme, siç ishin: Astronomia, Kimia , Shkencat e tokës, Matematika, Mekanika, Mjekësia, Optika, si dhe shumë shkenca të tjera. Fillet e shkencës në botën islame ishin si rezultat i pushtimeve të myslimanëve në vende e rajone të ndryshme, siç ishin pushtimi i Perandorisë persiane dhe pushtimi i më shumë se gjysmës së Perandorisë bizantine-romake, të cilët pushtime ishin të udhëhequr nga Halid bin Velidi.

Përmes këtyre pushtimeve myslimanët fituan dituri, si dhe i trashëguan ato me kujdes te brezat e ardhshëm. Prej të gjithë atyre shkencëtarëve kishte edhe aso që ishin të specializuar në drejtime të caktuara, si: Ibën Sinai në Mjekësi, Xhabir bin Hajan në Kimi , Ibën Halduni në Sociologji dhe shkenca të Historisë, Ibën Al Hajthami në Optikë, etj.

Pastaj, vendet apo qytetet në të cilat u trashëgua më së shumti dituria islame, që njëherit ishin edhe kryeqendra për myslimanët, ishin qytete si: Bagdadi, Maroku, Kajro, Kordoba etj. Ky zhvillim i shkencës te myslimanët pati ndikim edhe në rrjedhën e shkencës në Evropë. Evropianët, duke parë të arriturat e myslimanëve, merrnin veprat e tyre dhe i përkthenin ato në gjuhë të ndryshme. Kështu veproi Zherardi nga Kamerona, i cili përktheu 87 libra nga arabishtja në latinisht. Edhe pse u zhvilluan dhe u studiuan në mënyrë të hollësishme, shumë shkenca, nga të cilat kishte që ishin shumë të rëndësishme, si Matematika dhe Mjekësia, edhe në kohën bashkëkohore përdorin formula dhe elemente të zbuluara nga myslimanët qysh në kohët e vjetra. Në Matematik El Kuarizmi, nga emri i të cilit rrjedh Algoritmi, ishte ai që dukshëm kontribuoi në algjebër, nga libri i tij "Kitab Al Jabr". Ky libër ishte elementar dhe i pari prej llojit të tij. Pastaj edhe veprimet matematikore, si funksionet trigonometrike, përveç sinusit dhe kosinusit, ekuacionet kubike, gjeometrisë analitike, teorema e binomit, si dhe shumë të tjera, u nisën nga myslimanët.

Ndërsa, në Mjekësi kishte edhe më shumë zbulime, e prej tyre ishin mjetet që përdoreshin për operime të ndryshme, e të cilat përdoren edhe në ditët e sotme, por vetëm të modifikuara. Edhe shkencat farmaceutike, qarkullimi pulmunar dhe ai koronar, pulsimi, si dhe shumë sfera të tjera të mjekësisë u zhvilluan nga myslimanët. Pra, kjo ishte epoka në të cilën civilizimi islam shndriti dhe u zhvillua më së shumti, e jo siç e quajnë këtë periudhë, epoka e errët e mesjetës.

Ubejd Rrustemi 12/2



BLETA DHE MJALTI

Mrekullitë ne aspektin kuranor dhe atë shkencor

Bleta dhe mjalti janë ndër mrekullitë e Allahut, dhe tanimë vonë është vërtetuar edhe ajo që në Kuran ishte thënë shumë më herët, para XV shekujve. Allahu në Kuran e ka quajtur një sure me emrin e kësaj krijese të çuditshme.

Allahu xh.sh. thotë: " Zoti yt i dha instinkt Bletës. Ndërto shtëpi nëpër kodra (male), - "kjo është e para", nëpër drunj (pemë) - "kjo është e dyta", dhe nëpër kulmet që ata (njerëzit) i ndërtojnë - "kjo është e treta". Në çdo fjalë në këtë ajet ka mrekulli. Së pari Zoti në këtë sure, me fjalët "Ndërto, Futu , Merre", i drejtohet gjinisë femërore. Përse? Sepse, sipas dijetarëve islamë dhe ekspertëve të bletës, gjinia femërore është që i kryen të gjitha punët, ndërsa meshkujt vetëm ndonjë punë të lehtë.

Te ajeti i lartpërmendur thuhet se Allahu i dha instinkt bletës që të ndërtojë shtëpi në: a) Kodra (male); b) Drunj (pemë), dhe; c) Kulmet që njerëzit i ndërtojnë. Kjo është mrekulli në vete, për arsye se sot shkencëtarët e kanë vërtetuar se mjalti më i mirë është ai në: a) Kodra (male); i kemi dëgjuar njerëzit kur thonë se, ja, kjo është mjaltë mali, nuk është çfarëdo mjalti. Prandaj, Allahu e ka radhitur të parën Kodra (malet), e pastaj: b) Drunjtë. Ky është mjalti i shkallës së dytë, pra për nga cilësia, e pas tij vjen mjalti që del nga hojet e ndërtuara nga njeriu. Kjo gjithnjë sipas ekspertëve të kësaj fushe.

Imagjino se çfarë vlere ka ky mjalti që del nga barku i këtij insekti të vogël, që është një lloj fabrike! A e keni parë fabrikën e mjaltit? Një fabrikë e çuditshme!?

Procese të vështira kimike kryhen në barkun e bletës.



A mundet që njeriu ti bëjë këto procese, pra ta shndërrojë nektarin në mjaltë? Njerëzit thonë: "Po." Teorikisht njeriu e bën këtë, por a e di se për ta kryer një punë të tillë duhet një fabrikë sa qyteti i Tokios?! E çuditshme kjo për një proces të thjeshtë në mendjen e njeriut.

Po ashtu bleta ka disa veçori të çuditshme.

Së pari ajo ka shqisën e nuhatjes, pra tejet të veçantë dhe të saktë. D.m.th., ajo e di se ku duhet të shkojë dhe ku jo, dhe ajo nuk bie pos në të mira (nektar dhe gjëra të këndshme). Allahu xh.sh. ia ka dhënë edhe shqisën e shikimit. A e di se bleta sheh gjëra që ne nuk i shohim? Ajo sheh edhe nën dhe, mbi rrezet ultravioletë (vjollcë), dhe për këtë arsye ajo e di nga jashtë se çfarë ka në brendësinë e secilës lule.

Allahu xh.sh. bletës ia ka dhënë edhe shqisën e shijes, prej me të çuditshmeve që ia ka dhënë ndonjë gjallese. Nëse bleta e vendos gjuhën, apo sqepin që e nxjerr, në nektarin e lules apo frutit, ajo e di saktësisht përqindjen e përbërjeve të materieve dhe sheqerit brenda atij nektari, nga i cili pastaj thith ose jo.

Gjithashtu, prej veçorive të bletës është edhe fakti se nuk ka asnjë bletë që nuk punon, sepse ajo që nuk punon përjashtohet. Është e pamundur që bleta ta harrojë qëllimin e krijimit të saj. Imagjinojeni që kjo bletë, për ta bërë 1kg mjaltë, i duhet të qarkullojë gjithë rruzullin tokësor 10 herë! 10 herë vetëm për 1kg mjaltë!

Një e veçantë tjetër e bletës është se, kur ajo e thumbon njeriun , njeriu nuk duhet të fillojë të largohet, ngase ajo ka një shqisë që do t'u japë sinjal bletëve tjera në të gjitha hojet. Por çfarë iu thotë atyre?


Iu thotë ta sulmojnë këtë vend apo këtë person, e njeriu vrapon dhe i godet duke mos e ditur se kjo bletë i njofton edhe shumë të tjera!

Dhe, për fund, duhet ta përmendim se edhe në thumbimin e bletës ka dobi. Mjekët e specializuar në këtë fushë thonë: "Nëse të thumbon bleta 1, 2, 3 apo10 herë, ti do të shërohesh. Normalisht se kjo duhet të bëhet në konsultë me mjekët për arsye se te disa mund të ndikojë negativisht . Besojmë që krejt kjo është e vërtetë, për arsye se gjithçka që del nga barku i bletës është shërim, sepse Allahu i Madhëruar thotë: "Nga barqet e tyre del lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme, dhe në të cilin ka shërim (bar-ilaç) për njerëzit."

Pra bleta, si çdo krijesë e Allahut xh.sh., po prej Allahut është pajisur me veçori dhe specifika të shumta.


Besart Thaçi 12/2

E VËRTETA mbi teorinë e Darvinit



Personi që paraqiti teorinë e evolucionit ishte një natyralist amator anglez, Charles Darvini. Darvini kurrë nuk pati rastin të merrte një edukim shkollor në biologji, e për këtë arsye ai mori pjesë në një udhëtim 5 vjeçar rreth botës, me një ekspeditë anijesh. I impresionuar nga shumëllojshmëria e specieve të gjalla, ai supozoi se origjina e jetës gjendet në konceptin e "përshtatjes me ambientin."

Darvini shkroi librin "Origjina e llojeve", libër ky që nuk është i bazuar në ndonjë eksperiment apo zhvillim shkencor, por vetëm në imagjinatën e një njeriu të thjeshtë i cili kishte interes për natyrën. Disa nga pikëpamjet raciste të Darvinit janë: kur ai mori guxim të thotë se njeriu u krijua nga majmuni, ai supozonte evropianët e bardhë, që janë më të zhvilluar sesa zezakët, dhe abriogjenët australianë janë në të njëjtin nivel me gorillat. Evulocionistët e tjerë që pasuan teorinë e Darvinit besonin se krijesat gjysmë-njeri dhe gjysmë-majmun duhet të gjendeshin jo vetëm në mbetje fosilesh, por edhe në të gjallë.



Në fillim të shekullit XX gjurmimet për zbulimin e "lidhjeve ndërmjetësuese e të gjalla" quan në incident fatkeq. Një prej historive më të tmerrshme është e ajo e një burri me emrin Ota Benga. I lidhur me zinxhir dhe i futur në kafaz, ai u dërgua në ShBA, dhe iu ekspozua publikut së bashku me disa specie të tjera majmunësh, si "lidhja kalimtare më e afërt me njeriun". Më pas e dërguan në kopshtin zoologjik në New York, ku paraqitej si "stërgjyshi më i lashtë i njeriut". Duke mos pasur mundësi të duronte trajtimin që i bëhej, Ota Benga kreu vetëvrasje. Në këtë ideologji u mbështetën diktatorët më të mëdhenj që i ka njohur historia e njerëzimit. Ideologjia se "i sëmuri, i varfri dhe i dobëti nuk kanë të drejtë të jetojnë, por vetëm i forti, ndërsa të tjerët humbin dhe shkojnë drejt zhdukjes", bëri që tiranët e diktatorët si Stalini, Lenini, Hitleri etj., të shkaktojnë vdekjen e mijëra e miliona njerëzve të pafajshëm.

Esra Spahiu 12/4

MEDRESEJA



Janë ditë të ftohta tetori, që na ndajnë nga ngrohtësia e më të dashurve tanë: të dashurës nënë, të dashurit baba, vëlla e motër. Por sakrifica jonë është më e fortë se rezistenca ndaj motit të ligë që po e kaplon vendi ynw. E tërw kjo po ndodh për një qëllim, që unë dhe ti të jemi njw shtyllë e fortw e këtij Dini e Vatani. Medrese... Ah Medrese... Kush jam unë të shkruaj për ty? Ti nuk e meriton këtë copë letër, por meriton mund dhe sakrifica edhe më të mëdha. Ti meriton më shumë sesa meritojmë të gjithë ne. Ti je aq e rëndësishme për këtë popull, aq sa është uji për peshkun e detit, apo për lulen. Ti je vesë mëngjesi. Bletë me plot nektar. Ti je pastrimi im shpirtëror. Ti nuk je material i zakonshëm. Rruhanijeti qëndron mes kulmit dhe themelit tënd. Emri yt i bukur ndërron gjendjet e njerëzve, ashtu siç shkrin zjarri akullin. Po të pyesësh gjeneratat e mëhershme, ata do të thonë se nuk ka përkufizim për këtë pallat. Sepse çdo përkufizim lë diçka të madhe pa përmendur. Nuk ka fjalë që e përshkruan ngrohtësinë, emocionin dhe dashurinë që e dhuron ky vend. Sot është herët për mua dhe për ty medresist, por ti e unë duhet ta lexojmë këtë shkrim, që të paktën ta dimë çfarë kemi, dhe më vonë ta kujtojmë çfarë kishim.

Ahhhh... nuk është e lehtë ta lësh nënën me lot në sy, e t'ia mësysh bankave e të ngujohesh brenda mureve një godine që ishte rezistencë e fortë kundër çdo regjimi. Dhe kjo vetëm e vetëm të dëgjojmë zërin e ëmbël të dritëdhënësve që po na e kënaqin zemrën.

Medrese, ti je mrekulli. Nuk je ndërtuar kot, dhe vetëm të quhesh shkollë e diplomës. Ti je ndërtuar të jesh shkollë shpirtërore, edukuese shpirtërore, e moralit dhe fisnikërisë.

Ti më mësove ta njoh Krijuesin tim të vërtetë. Ti më mësove të njoh Pejgamberin tim, se ai ishte i moralshëm e nuk ishte ashtu siç e paraqitën ata që pranuan djallin për Zot e i thyen ligjet e Krijuesit të vërtetë. E dini se ku qëndron fshehtësia e bukurisë së kësaj shkolle: "Medreseja u nis me lot të fazanëve, dhe do të përfundojë me lot të maturantëve."

Milazim Mani 12/1



MOS U DORËZO!

Është shumë vështirë të qëndrosh i pastër në një botë ku pa pushim përpiqen të të hedhin baltë.

Ndonjëherë edhe të godasin. Por, ti je syçelë, e mbrohesh. E ata nuk ia arrijnë qëllimit. Ndonjëherë tjetër, edhe pse aq shumë dëshirojnë të të përlyejnë, tërhiqen. Sepse nuk kanë guxim.

Çfarë nuk provojnë ata! Pse e bëjnë këtë?

E bëjnë sepse kanë për qëllim t'i shkatërrojnë ëndrrat tua, shpresat dhe synimet tua. Nderin tënd dhe krenarinë tënde. Por, ata harrojnë se kushdo që hedh baltë mbi tjetrin, është i pari që i bën të pista duart e tij. */Ajshe Emine Shala 11/4*

MALL PËR PEJGAMBERIN A.S.

Durimi më është sosur për të parë fytyrën tënde, o Pejgamber!

Tani, këtu i vetmuar, mundohem ta ndiej afërsinë e shpirtit tënd. Mundohem ta ndiej kënaqësinë e këshillave tua.

Kësaj bote të errët ishe ti që i dhe dritë, dhe dua që tani edhe shpirtit tim t'i japësh dritën dhe ngrohtësinë tënde.

Malli për ty nuk shuhet asnjëherë, o Pejgamber i Allahut, derisa të takohemi në xhenetet e larta!

Ti je ai që më frymëzon, që hidhërimin tim ta shndërroj në buzëqeshje.

Ti je ai që më frymëzon për vepra të mira.

Malli për ty tani po më djeg zemrën, por shpresa tek unë, se edhe një herë do të të përqafoj, nuk vdes kurrë.

Tani, në këtë dhomë të errët, salavate po të dërgoj.

Ahh... Pse nuk ma mundësoi Allahu të jem në mesin e atyre njerëzve që shikuan fytyrën dhe buzëqeshjen tënde? T'i dëgjonin këshillat, e të kënaqeshin me ty?

Te ishe këtu, pranë meje, për një çast të vetëm, që të të tregoja për gjendje e umetit tënd, të cilët, ndoshta, të kanë harruar!

Sikur ta di se pas vdekjes do të të takoj, vdekja për mua do të ishte më e dashur se jeta.

Mendim Sllamniku 12/1

TRËNDAFILI I ZEMRËS SIME

Në këtë natë të gjatë gjumi duket sikur të jetë në mosekzistencë. Diçka brenda meje emrin tënd thërret. Dua të flas me ty, e të t'i tregoj hallet për umetin tënd. Dua të t'i tregoj plagët që e kanë kapluar me vite. Egërsirat vazhdimisht në të hedhin kripë. Lotët e umetit tënd botën e kanë vërshuar, e secila pikë e thërret emrin tënd. O i Dërguar i Allahut, egërsirat na e kanë pirë gjakun, e na e morën nderin tonë! Krenarinë na e copëtuan. Nuk më ka mbetur më forcë. Në rrugën time tashmë jam rrëzuar.

Papritur e ndjeva afër buzëqeshjen tënde, që asnjëherë nuk u vyshk. Pa marrë parasysh vështirësitë që po kalonte, më dha forcë për t'u ngritur e për të vazhduar udhëtimin tim. Më mungon aroma jote, edhe pse nuk e ndjeva kurrë. Më pas edhe fytyra jote, ani pse nuk e pashë kurrë. Më mungon buzëqeshja jote, edhe pse nuk e përjetova kurrë. Kërkoj ribashkim me ty, edhe pse takimi i parë nuk ndodhi kurrë. Tani fjalët janë shteruar, e heshtja mbizotëron. Dua të flas, por nuk di çka të them. Vallë, a ka mbetur diçka për të thënë?! Më mungon, o i Dërguar i Allahut, o Trëndafili i shpirtit tim! */Tahire Hasani 12/4*

FRENIMI I ZEMËRIMIT

Dijetarët kanë përmendur disa mënyra për frenimin e zemërimit të papëlqyeshëm:

Bërja e duasë. Ai, Allahu i Madhërishëm, thotë: "Lutmëni, që t'ju përgjigjem!" (Gafir 60)

Përmendja e Allahut (dhikri). "Vetëm me përmendjen e Allahut zemrat gjejnë prehje dhe qetësi." (Er-Rad 28)

Këshillimi i myslimanëve me njëri-tjetrin. "Këshillo, sepse këshilla është e dobishme për besimtarët!" (Edh-Dharijat 55)

Kërkimi nga Allahu për mbrojtje nga shejtani i mallkuar.

Ndryshimi i pozicionit të qëndrimit. "Nëse dikush zemërohet kur është në këmbë, le të ulet dhe të qëndrojë ashtu derisa t'i kalojë inati. Nëse edhe pas kësaj nuk qetësohet, atëherë le të shtrihet!"

Mënjanimi i stërmundimit apo lodhjes së tepërt. Për këtë arsye Pejgamberi a.s i tha njërit prej shokëve të tij: "Myslimani ka detyrime edhe ndaj trupit të tij." (Transmeton Buhariu)

Largimi nga të gjitha ato gjëra që njeriun e bëjnë të zemërohet.

Një këshillë e fundit për ju që zemëroheni: "Fol vetëm atëherë kur zemërimi yt ka rënë!" Kjo është mjaft etike.

Mekë Ilazi 11/4

* *Bazuar në librin "40 hadithe të zgjedhura nga Imam Neveviu".*

LEXO, MENDO DHE PUNO

(këshilla)

Fale namazin porsa ta dëgjosh thirrjen, pa marrë parasysh se në çfarë situate je!

Lexo, mëso, dhe me kujdes dëgjo Kuran! Allahun përkujtoje!

Asnjë pjesë të kohës mos e kalo pa dobi!

Mundohu ta mësosh dhe ta flasësh gjuhën letrare arabe, sepse ajo është shenjë e Islamit!

Mos e tepro gjatë të qeshurit, sepse zemra është e lidhur me Allahun xh.sh. dhe e vendosur!

Mos e rrit zërin më shumë sesa kanë nevojë të të dëgjojnë, sepse ai është shqetësim!

Largohu bisedave mbi njerëzit dhe ndjenjat e të tjerëve!

Fol vetëm për të mirën!

Mos e tepro gjatë bisedimeve kundërshtuese, pa marrë parasysh se për çfarë kundërshtohet!

Njihu me vëllanë/motrën kur ta takosh, edhe pse nuk kërkohet prej teje!

Egzona Bellagoshi 11/4




LUMTURIA E SHPIRTIT - NËNA!

Sa çudi me njeriun! Si mund ta dojë dikë kaq shumë? Ndoshta sepse është nga ajo që të nxori në këtë jetë. E para që të dha ngrohtësi e dashuri. Është ajo që ndien dhimbjen më të madhe për ty, pavarësisht çdo gjëje që të është dhuruar. E kjo vetëm për të të mbështetur dhe këshilluar çdo herë. Nëna është sikur një oqean përplot dashuri, e që nuk ka fund. Ajo është sikur mjalti, që i jep ëmbëlsi jetës sonë. Është sikur lule, që nuk ngopesh dot me aromën e saj. Sa herë që ajo buzëqesh, të jep jetë dhe forcë që të vazhdosh edhe më tutje. Ajo e di që është e lumtur, e kjo mua më lumturon më shumë. E di sa është e rëndësishme për mua, prandaj dua ta kem pranë. Të dua nënë! Ti je drita e syve të mi.

/ Medina Behrami 11/5





BISEDA MES MËSUESIT DHE NXËNËSIT

Nxënësi ia ktheu shpinën, ndërsa mësuesi i tij, Imam Shafiu, i shkoi në shtëpi dhe e këshilloi:

O Junus, neve na bashkojnë me mijëra çështje, ndërsa ti dëshiron të ndahesh për shkak të një mospajtimi?!

Mos tento që në çdo mospajtim të dalësh fitimtar, ngase shpeshherë më me rëndësi është të fitosh zemrat sesa debatet!

Mos i shemb urat që ndërtove dhe nëpër to kalove, ngase mund të të duhet që të rikthehesh prapë përmes tyre!

Çdoherë urreje gabimin, por mos e urrej gabimtarin! Urreje mëkatin, por mëshiroje mëkatarin!

Kundërshtoje fjalën, por respektoje thirrësin, sepse qëllimi ynë është që ta shërojmë sëmundjen, e assesi të vrasim të sëmurët!

Leuarta Pantina 11/4

LUTJET
E PEJGAMBERËVE TË ALLAHUT

Lutja e Ademit a.s.: "Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetvetes. Në qoftë se nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!" (Al-Araf, 23)

Lutja e Nuhut a.s.: "Zoti im, më fal mua dhe prindërit e mi, dhe ata që hyjnë në shtëpinë time, duke qenë besimtarë. Edhe besimtarët e besimtaret, ndërsa jobesimtarëve mos u shto tjetër vetëm se dëshpërim!" (Nuh, 28)

Lutja e Hudit a.s.: "Unë i jam mbështetur Allahut. Zotit tim dhe Zotit tuaj. Nuk ka asnjë krijesë e gjallë që nuk është nën sundimin e Tij. Vërtet Zoti im është i drejtë." (Hud, 56)

Lutja e Ibrahimit a.s.: "O Zoti im, më bëj mua prej atyre që falin namazin, e edhe prej pasardhësve të mi, dhe pranoje lutjen time, o Zoti ynë!"

Zoti ynë, më fal gabimet mua dhe prindërve të mi, fali dhe të gjithë besimtarët ditën kur japin llogari!" (Ibrahim, 40-41)

Lutja e Jakubit a.s.: "Unë hidhërimin dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut, dhe unë di për Allahun atë që ju nuk e dini." (Jusuf, 86)

Lutja e Jusufit a.s.: "Zoti im, t'i më ke dhënë mua pushtet, më mësove mua komentimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je kujdestari mi në dynja e në ahiret, më bën të vdes mysliman, dhe më bashko me të mirët! (Jusuf, 101)

Lutja e Ejubit a.s.: "Më gjeti fatkeqësia, e Ti je më Mëshiruesi ndër mëshiruesit!" (Al-Enbija, 83)

Lutja e Shuajbit a.s.: "Zoti ynë ka përfshirë me diturin e Tij çdo send. Ne i jemi mbështetur Allahut. Zoti Ynë, vendos mes nesh dhe popullit tonë gjykimin Tënd të drejtë, se Ti je më i miri gjykatës!" (El Araf, 89)

Lutja e Musait a.s.: "Zoti im, unë e ngarkova veten, e Ti më fal mua! Dhe Ai ia fali, se ai është që fal shumë, është Mëshirues.

"Zoti im, betohem në ato të mirat që m'i dhurove mua, se kurrë nuk do të vihem në ndihmë të kriminelëve!" (Al-Kasas,16-17)

"Ma zgjero (më ndihmo) gjoksin tim, dhe më lehtëso në këtë punën time! Ma zgjidh nyjën e gjuhës sime, që ta kuptojnë fjalën time! Më cakto një ndihmëtar nga familja ime, Harunin, vëllanë tim." (Ta-ha, 87)


Lutja e Junusit a.s.: "Nuk ka Zot përveç Teje. Ti je i Pastër, e nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtësi vetes sime." (El-Enbija, 87)

Lutja e Sulejmanit a.s.: "Zoti im, ma mundëso të të falënderoj për të mirat Tua që m'i dhurove mua dhe prindërve të mi, dhe të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen! Me mëshirën tënde më fut në mesin e robërve Tu të mirë." (En-Neml, 19)

Lutja e Zekerijait a.s.: " Zoti im, mos më lër të vetmuar, se Ti je më i miri trashëgues!"

Lutja e Muhamedit s.a.v.s: "Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe na ruaj nga dënimi me zjarr!"

Berat Namani 12/1



DISA KËSHILLA TË HASAN EL BASRIUT RRETH MËSIMIT



Mos prit kohë dhe ditë të qëlluar për mësim! Dihet se çdo orë dhe çdo ditë është e qëlluar për mësim.

-Mos kërko vend të përshtatshëm për mësim! Dije se çdo skutë është vendi ideal për mësim!

-Assesi punën e sotme mos e lër për nesër! Për arsye se çdo ditë ka punët e veta.

-Në një kohë të caktuar bëj vetëm një punë, vetëm një mësim, respektivisht puno rreth vetëm një problemi, derisa të mos të dobësohet kujdesi dhe çudia!

-Pa e kryer njërin mësim mos kalo në tjetrin! Lëshimi përgjatë një problem është përtaci e masakruar.

-Mëso vazhdimisht dhe me kujdes, çdo ditë dhe në të njëjtën kohë! Nëse lodhesh me një punë, atëherë ndërroje atë ose ngadalësoje ritmin, por mos pusho!

-Mendo mirë pasi që puna nuk do të të thotë vetëm të lëvizësh, të lexosh apo të shkruash! Njeriu që mendon punon më mirë se xehetari në minierë.

-Asnjëherë mos e vlerëso produktivitetin e mësimit me orë, por shihe rezultatin e asaj që ke mësuar!

-Në punët mendore-mësimore, dy apo tri orë të mjaftojnë.

-Çdo ditë lexo me zë nga dhjetë faqe nga një vepër e mirë, ashtu që të të zhvillohet aftësia e të folurit!

-Mëso përmendësh pjesët e bukura që i lexon.

-Pas përfundimit të mësimit, përsërit ato në kujtesën tënde, dhe merr shënime!

-Së fundmi, përkujto se vlera e individit është e fshehur nën gjuhën dhe majën e lapsit të tij! Ajo shfaqet ndërmjet fjalës dhe shkrimit.

Mirvete Karaliti 10/3

SHFLETO TUTJE

Të lutem, dil menjëherë në faqen tjetër...!

Nëse të kanë ngulfatur angazhimet, të kanë mbytur brengat, hallet, mos ëndërro në një vend! Të lutem dil në faqen tjetër, dhe filloje menjëherë një jetë me Allahun e Madhëruar!

Nëse nuk gjen shok të sinqertë, besnik dhe të drejtë, të lutem dil në faqen tjetër, dhe thuaj: "Shoku im më i mirë është Kurani." Nëse fillon leximin e faqes së parë nga Kurani, mos nxito e të mjaftohesh vetëm me atë, por kalo faqe më faqe, dhe lexo sa më shumë!

Nëse i arrin retë, dëgjohet bubullima e tyre, e pastaj bie shi. Të lutem dil në faqen tjetër menjëherë, edhe nëse ajo është e lagur! Shko drejt strehimit, që të mos lagesh i tëri nga shiu!

Nëse njerëzit mburren dhe krenohen me fjalët dhe shprehjet e tyre, ti mos i imito ata! Të lutem dil në faqen tjetër, dhe krenohu me heshtjen tënde!

Nëse jeta jote është rutinë e mërzitshme, kur nata dhe dita, dielli dhe hëna, pra janë njësoj, të lutem dil në faqen tjetër, dhe kërko menjëherë titullin i cili quhet: "Arti i avancimit personal dhe menaxhimit të kohës".

Nëse i ke bërë keq vetes, dhe pikat e zeza kanë mbuluar zemrën tënde, si dhe mëkatet të kanë rrethuar, mos u dëshpëro e as mos u pikëllo! Të lutem dil në faqen tjetër, dhe lëre të kaluarën tënde! Fillo të jetosh përsëri!

Lirigzona Pllana 12/3



ENGJËJT GARUAN PËR TA SHPËTUAR ATË



Ishte njëherë një tregtar, i cili lëvizte prej një vendi në një vend tjetër, kryesisht për tregti. Ai shkonte prej një qyteti në një qytet, e prej një fshati në një fshat. Një ditë ai kalon nga një luginë, dhe papritur takohet me një plaçkitës. Ishin vetëm, dhe askush s'ishte përreth. Plaçkitësi e ndalon atë, ia vendos thikën në fyt, dhe i thotë: "Unë do të të vras ty, dhe do të ta marr gjithë pasurinë!" Tregtari i thotë: "Të lutem, merre gjithë pasurinë time, por më lër të jetoj!" Ai i thotë: "Jo. Unë gjithsesi se do ta marr pasurinë, dhe gjithsesi do të të vras." Tregtari, kur e pa se plaçkitësi nuk po bindej, dhe se po insistonte ta vriste, i tha: "Në rregull, mund të më vrasësh dhe të ma marrësh pasurinë, por më lejo të bëj një gjë të fundit! Më lejo t'i fal dy rekate namaz!"

Plaçkitësi i tha: "Bëj çka të duash, e unë po të pres!" Ai bëri gabim shumë të madh që e la të falej, sikur ta dinte! Tregtari filloi të falej. Ai fali rekatin e parë, dhe pastaj edhe të dytin. Tanimë ishte në sexhde, në vendin dhe në momentin për të cilin Pejgamberi, paqja qoftë mbi të, ka thënë se: "...atëherë je më së afërmi me Allahun, prandaj atëherë lute Allahun për atë çka dëshiron". Sa ishte në sexhde ai e filloi një dua të gjatë, të ndarë në tri pjesë. Ai në sexhde tha: "Të lutem Ty, o Ti, drita e fytyrës së të Cilit ka mbushur Arshin!" E luti me emrat e Tij të bukur, me atributet e Tij të mrekullueshme, dhe në fund tha: "O Ti që i përgjigjesh lutjes së atij që ka nevojë për Ty, më shpëto mua nga ky plaçkitës!" Pastaj i kërkoi tri herë me zemër: "O Shpëtues, më shpëto mua! O Shpëtues, më shpëto mua! O Shpëtues, më shpëto mua!"

Tregtari, ende pa e përfunduar mirë lutjen, dëgjoi hingëllimin e një kali që vraponte shumë shpejt, mbi të cilin ishte një luftëtar me fytyrë të mbuluar, e i cili mbante një shpatë në dorën e tij të djathtë. Para se plaçkitësi të bënte ndonjë gjë, luftëtari e vrau atë, dhe ai vdiq. Tregtari u ngrit dhe e përqafoi luftëtarin, dhe i tha: "Zoti të bekoftë! Prej nga je ti, dhe prej nga erdhe këtu?" Ai tha: "Unë jam një melek nga qielli i katërt. Kur e lute Allahun herën e parë, ne të dëgjuam ty. Kur e lute Allahun për herën e dytë, qiejt u dridhen. Dhe kur e lute Allahun për të tretën herë, ne garuam për tek Allahu, dhe unë i tejkalova engjëjt tjerë për tek Ai, dhe i thashë: "O Zot, më dërgo mua ta shpëtoj! Dhe Allahu më lejoi mua." Pastaj engjëlli u zhduk tutje. Kështu, duasë së personit që është në nevojë Allahu do t'i përgjigjet gjithmonë. Prandaj, mos i humb shpresat kurrë!

Valdrinë Abullahu 12/3

PSE E ZGJODHA

Mumin Baftiu 10/1: Pse e zgjodha Medresenë?! Kjo pyetje ka filluar të më shtrohet shpesh, sidomos tani kur vetëm jam nisur këtij rrugëtimi. Nuk e di se pse njerëzit çuditen kur dëgjojnë se kam zgjedhur këtë shkollë! Ndoshta mendojnë se është kushedi çfarë, apo mendojnë se aty shkojnë vetëm fëmijët e hoxhallarëve, si dhe ata që nuk janë edhe aq të mirë në mësime! Në fakt është krejt ndryshe. Këtu vijnë nxënësit më të mirë. Sikur t'i dinin mirësitë dhe "mrekullitë" që ka kjo shkollë, atëherë secili prind, pa e menduar gjatë, do te sillte fëmijën e tij në këtë shkollë.

Medreseja është vend i shenjtë dhe, po të mundja, çdo fëmijë që i thotë vetes fëmijë i mirë e besimtar, do ta sillja në këtë shkollë. Për fund, kam një këshillë: "Nëse dëshiron që fëmija yt të jetë në rrugën e drejtë, si dhe i udhëzuar prej Allahut xh.sh., atëherë bëj që fëmija yt të vazhdojë shkollimin në Medrese, dhe do ta shohësh se kurrë nuk do të pendohesh!

Amar Rama 10/1: S'ka dyshim se marrja e vendimeve, dhe veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me të ardhmen e njeriut, nuk është një hap i lehtë.

Për të marrë vendimin e duhur njeriu së pari përcakton qëllimet e tij që synon, që vendimi i marrë të jetë në favor të vizionit dhe qëllimeve. Ai gjithashtu kësaj rruge ia bashkon edhe konsultat me njerëzit e duhur.

Prandaj, unë si qëllim për fazën vijuese, pra pas shkollës fillore, përcaktova që krahas seriozitetit dhe cilësisë së arsimimit, të zgjedh një shkollë nga e cila do të përfitoja edhe në rrafshin e edukimit dhe formimit të duhur human dhe intelektual.

Për aq sa pata mundësi të analizoj dhe të bëj krahasime për të marrë vendimin e duhur, të gjitha rezultatet dilnin në favor të Medresesë, veçanërisht kur para vetes kisha modelin më të mirë, prindin tim, i cili kaloi po nëpër bankat e kësaj shkolle, por edhe vëllanë tim, i cili ende po vijon mësimet në këtë shkollë.

Tërë ajo që e përmenda është vetëm një përshkrim i përgjithshëm i këtij rrugëtimi, ngase lëndët janë fetare dhe shkencore, profesorët janë të përgatitur dhe të zellshëm, siguria dhe ambienti është shumë i përshtatshëm; këtu mjafton që nxënësi, pa u hamendur fare, ta marrë vendimin e t'i bashkohet radhës së gjatë të konkurrentëve për të qenë nxënës i kësaj shkolle të bekuar.

Shpresoj që me zell dhe angazhim do ta dëshmoj meritën që të jem nxënës i kësaj shkolle, dhe në të ardhmen të jam një përfaqësues i denjë i kësaj vatre të arsimit dhe edukimit.

Albesian Guri 10/1: Ku ka vend më të mirë se vendi në të cilin mësohet feja e Allahut?

Në këtë shkollë, përveç dijes, e merr edhe moralin e lartë dhe të veçantë.

Të mirat që i marrim nga kjo shkollë-medrese, jo vetëm tash, por tërë jetën do të na shërbejnë, si neve ashtu edhe shqërisë.

Kjo është arsyeja pse zgjodha Medresenë për ta vazhduar shkollimin tim.

Endrit Rudari 10/1: Unë, si nxënës në Medrese, ndihem i privilegjuar dhe shumë i lumtur që kam zgjedhur Medresenë për ta vazhduar shkollimin tim.

Medresenë e kam zgjedhur për shkak se është

MEDRESENË?

shkolla që më së miri të përgatit për jetën. Në këtë shkollë morali, disiplina dhe mësimi janë në një nivel mjaft të lartë. Krejt në fund, ajo që e dallon më së shumti këtë shkollë nga shkollat tjera është se këtu mësohen edhe lëndët fetare por edhe shkencore. Pra, këtu mësohet Fjala e Allahut xh.sh., si dhe lëndët shkencore.

Granit Sadiku 10/2: Para se të filloj të shpjegoj arsyet pse e zgjodha këtë shkollë, dëshiroj ta përmend fjalën e më të mirit të njerëzve: "Kujt Allahu ia do të mirën, ia mundëson të mësuarit e fesë së Tij."

Unë e konsideroj shkollën më të mirë, sepse i ka tri elemente kryesore, e të cilat janë: morali, feja dhe dituria. Por, kjo shkollë posedon edhe më shumë se kaq.

Kjo shkollë, me të gjitha cilësitë e bukura të saj, ka bërë që të jetë atraktive dhe zgjedhja e shumë nxënësve, dhe besoj se këto kanë qenë arsyet e kësaj përzgjedhjeje, për të cilën personalisht jam krenar çdo ditë e më shumë.

Miran Shehu 10/2: Zgjodha Medresenë sepse ishte i vetmi planet ndër miliona të tjerë që kishte jetë. Ishte tempulli i vetëm i dijes ku mund të studioja dy prej gjërave më themelore në jetë: Fenë dhe Shkencën. Dhe, me ndihmën e profesorëve të Medresesë, mund të bëja thurjen e të dyjave, dhe atë në mënyrë të përkryer, ashtu siç edhe do ta zbatoja urdhrin e parë të Allahut xh.sh., dhe fjalët e para që i tha Muhamedit a.s.: "Lexo (mëso studio)!"

Rijad Sogojeva 10/2: Muhamedi a.s ka thënë në një hadith të saktë, e të transmetuar nga Muaviu: "Kujt Allahu ia do të mirën, atij ia mundëson të kuptuarit e thellë të fesë." Unë zgjodha Medresenë pasi dua të di çdo gjë rreth Krijuesit dhe të Dërguarit të Tij. Po ashtu në Medrese ka shumë lëndë me vlerë, pa marrë parasysh se a janë fetare apo shkencore.

Medreseja është një shkollë nga e cila dalin shumë hoxhallarë e dijetarë. Falënderoj Allahun që më zgjodhi të jem njëri prej nxënësve të kësaj shkolle.

Dren Lipaj 10/2: Mua jeta më vendosi përballë dy mundësive: të zgjidhja Medresenë, apo të zgjidhja ndonjë shkollë tjetër ku do të vazhdoja arsimimin e mesëm dhe rrugëtimin tim, që e kisha nisur qysh nga shkolla fillore. Vendosa të zgjedh Medresenë.

Por, besoj se duhet ta dini pse zgjodha Medresenë?

E zgjodha Medresenë, thjesht sepse është më e veçanta ndër shkollat tjera. Në këtë Medrese shumë gjenerata u edukuan dhe u arsimuan. Medreseja është vendi ku mësohet feja e Zotit xh.sh., ku mësohet se si ta duam atdheun, si dhe të jemi shembull për të tjerët. E pse mos të isha pjesë e këtij misioni edhe unë? Pse të mos mësoja fenë e Allahut xh.sh., dhe të ndërtoja një karakter të denjë të një besimtari dhe të një atdhetari?!

Sot, falë Allahut xh.sh., unë vijoj mësimet në këtë shkollë, dhe ndihem krenar që jam pjesë e saj. Gjithashtu jam me fat që marr edukatë dhe dije nga profesorët e kësaj shkolle.

Ka thënë Muhamedi a.s.: "Kujt Allahu ia do të mirën, ia do të kuptuarit e thellë të fesë së Tij."

përzgjodhi: Labeart Jasiqi 12/1

PSE E ZGJODHA MEDRESENË?

Alma Çerkini 10/4: Zgjodha Medresenë? Ngase vetëm në këtë vatër të diturisë mund ta gjeja veten. Dhe, në këtë shkollë arrita të gjeja atë që nuk e gjeta në shkollat tjera. Pra, ju këshilloj të gjithëve të bëheni pjesë e saj!

Hafije Frangu 10/4: Suksesi më i madh që njeriu mund ta arrijë në këtë jetë është të bëhet shkaktar për të shpëtuar së paku një person nga hyrja në zjarr, duke e udhëzuar drejt adhurimit të Zoti të vetëm. Mendoj se vetëm Medreseja ma mëson se si të bëhemi njerëz të tillë.

Hatixhe Hasani 10/4: Historitë madhështore të suksesit gjenden në shkolla madhështore. Për këtë arsye zgjodha Medresenë, që të jem personazh i një historie që ka burim të një shkolle madhështore.

Albana Hajraj 10/4: Zgjodha Medresenë sepse një gjë që njerëzit në vendin tim e kanë lënë në harresën e tyre, e gjejë çdo ditë vetëm në këtë vatër diturie. E ajo është kërkimi i diturisë së mirëfilltë, e cila që na bën njerëz të përgatitur për jetën.

Mirvete Karaliti 10/3: Medreseja është një ndër shkollat e vetme ku mësohet fjala e Allahut, ku zbatohet rruga e të dërguarit të Tij, dhe porositë që vijnë nga Libri i Zotit. Ndonëse kërkimi i diturisë këtu nuk është edhe aq i lehtë, ne nuk harrojmë porosinë e Pejgamberit tonë të dashur: "Kush merr rrugën për të kërkuar dije, Allahu atij ia lehtëson rrugën për në Xhenet." Dhe kjo është arsyeja thelbësore pse unë erdha këtu, me dëshirën më të madhe që të bëhem pasuese e shembullit më të lartë në këtë botë, duke e stolisur veten me dijen që na jep Medreseja.

Mirjeta Llapashtica 10/3: Zgjodha Medresenë për arsye se është shkolla e vetme ku ne mund t'i fitojmë mirësitë e dynjasë, dhe në të njëjtën kohë edhe hapat për të arritur në Xhenet.

Firdevse Gashi 10/3: Unë mendoj se Medreseja është rruga më e drejtë për të arritur cakun e suksesit tim, që gjithmonë e kam ëndërruar. Për të arritur deri në fund kam për të kaluar shumë sfida, por vetëm me dijen që marr këtu dhe me jetësimin e durimit në jetën time, pra që e mësoj në këtë vend, mendoj se do t'ia dal me lehtë.

Ermira Gubetini 10/3: Unë medresenë e zgjodha pasi është një ndër shkollat ku mësohet feja e Allahut xh.sh., e që ne të gjithë e duam. Zbatimi i kësaj rruge shpien ëndrrën e të gjithëve në Xhenetin më të lartë. Prandaj, ndonëse ky rrugëtim parashihet të jetë tejet i gjatë, si dhe me shumë lodhje e mundim, prapëseprapë ndiej se rrugët e gjata parashikojnë një të ardhme të ndritur.

përgjodhi: Gjyltene Mavriqi 12/3

THËNIE NGA HOXHË JAKUP ASIPI



1 -Në barnatore mos i zgjidhni ilaçet për nga paketimi, sepse edhe helmi e ka paketimin e bukur!

2 -Mësojeni diturinë, por kurrë nuk do të paguheni te Zoti nëse nuk do të punoni me të!

3 -Rini, kthjellu! Disa gjëra që tani ju duken të ëmbla, në rini, do të bëhen të hidhura në pleqëri, e do t'ju shkaktojnë vetëm dhembje e vuajtje të mëdha.

4 -Në botë nuk duhet të ketë ditë të nënës, por jeta kushtuar nënës.

5 -Shamia është norma e Allahut. Kush e ka luftuar shaminë, e ka luftuar Allahun.

6 -Shoqërimi me libra është njësoj si shoqërimi me njerëz. Mund të hasësh në njerëz të mirë, dhe të këqij.

7 -Mos lejoni tua tregojnë drejtimin ata që e kanë humbur edhe rrugën!


8 -Shqiptarët janë zemra, palca, mushkëritë dhe truri i Ballkanit.


9 -Tru më të pastër se truri i shqiptarëve nuk shihet dhe nuk do të ketë, nëse mbetet kështu i freskët, dhe nëse nuk e turbullojnë të tjerët.

10 -Shqiptarët janë të parët që e kanë pranuar Islamin, nga vetëdija e lartë që e kishin për ta kuptuar menjëherë fjalën e urtë dhe fjalën e vërtetë.

11 -Bëhu i mençur dhe mëso e studio! Por, kur të hash bukën e Allahut, thuaj: Elahmdulilah!

Omer Vehapi 12/2





DHURATAT MË TË BUKURA

Dhurata më e bukur që mund t'i bësh njerëzve që të rrethojnë është Buzëqeshja
Dhurata më e bukur që mund t'i bësh familjes tënde është Krenaria
Dhurata më e bukur që mund t'i bësh shoqërisë është Besnikëria
Dhurata më e bukur që mund t'i bësh personit që e do është Sinqeriteti dhe Dashuria...

Përparim Ruhani 12/1

Thënie

-Mënyra se si vepron me njerëzit e përcakton formën e sjelljes së tyre ndaj teje.

-Mos fito pasuri duke humbur njerëz, pasi fitimi i njerëzve është mënyra për ta fituar pasurinë!

-Trajtoji njerëzit në mënyrë humane, pa marrë parasysh dukjen, pasurinë apo statusin e tyre!


-Predikuesi më i mirë është ai që së pari predikon me vepra, e pastaj me fjalë.

-Bisedo për gjëra që të tjerët dëshirojnë t'i dëgjojnë, e jo për ato që ti dëshiron të flasësh!

-Mos mendo se njerëzit janë të natyrës së njëjtë! Përkundrazi, ata dallojnë jashtëzakonisht shumë.

-Pastroje nijetin nëse do që shkathtësitë tua të brendshme të shndërrohen në vepra të adhurimit, me të cilat do t'i afroheshe Allahut xh.sh.!

Amir Koliqi 12/1



MEDRESEJA, 65 VJET EDUKIM DHE ARSIMIM PËR FE DHE ATDHE

Medreseja, si vatër diturie, ishte dhe do të mbetet dëshmitare e shumë sukseseve të nxënësve që përcolli. Pa dallim lëmi, shkolle apo vendi, nxënësit e Medresesë gjithmonë triumfuan.

Megjithatë, mëngjesi i këtij nëntori agoi ndryshe. Me kënaqësi e shumë hare filloi manifestimi i përvjetorit të hapjes së medresesë. 1 Nëntori, është dhe do të mbetet ditë e shënuar për të gjithë ne.

Si në çdo program tjetër, edhe këtë herë programin e filluam me leximin e fjalës së Allahut, Kuranit famëlartë, për të vazhduar më tej me tregimin e historikut dhe vështirësive që kaloi Medreseja për themelimin dhe zhvillimin e saj gjer në ditët e sotme. Me kënaqësi dëgjuam fjalimin e drejtorit të Medresesë, Jakup ef. Çunakut, e pas tij, për t'ia shtuar ëmbëlsinë këtij takimi, foli edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava. Për respektin dhe përgjigjen ndaj ftesës sonë, fjalën e mori edhe zëvendësministrja e Arsimit, Anila Stakofci Demaj. Pa dyshim se nuk mungoi edhe shprehja e dashurisë ndaj atdheut. Këtë e dëshmoi kori i djemve, zërat e të cilëve thyen muret brenda zemrave që kishin harruar ilahinë me tekst të myftiut Naim ef. Tërnava "Zgjohu Kosovë".

"Beso o qenie njerëzore", ishte pjesa e shkëputur dramë-poetike, e prezantuar nga një grup vajzash. Me fjalët e tyre ato rrëqethën zemrat e publikut, duke treguar për rrugëtimin njerëzor dhe sfidat e njeriut gjatë jetës. Nuk munguan as monologët. Si nga djemtë ashtu dhe nga vajzat, me zërat e tyre nxënësit shfaqën talentin e tyre









dhe vlerat e kësaj shkolle. Minutat po kalonin, e nga fundi i erdhi koha edhe korit të vajzave, si relaksim për minutat e kaluar në këtë vend.

"Amaneti", një pjesë tjetër dramatike, e cila preku ndjenjat e çdonjërit që po dëgjonte, prezantoi mesazhin e kësaj shkolle, që nga gjeneratat e pare e deri më sot. Për t'ia shtuar këndaqësinë, dhe për të dëshmuar vlerën dhe punën që bëri Medreseja me nxënësit që përcolli, fjalën e mori edhe Rasim Demiri. Ishte ky që tregoi vlerat e Medresesë dhe sukseset që kishte arritur si një nxënës i saj. Ky është gjithashtu ministër i Qeverisë së Kosovës.






Ngadalë minutat kaluan, e pas mbylljes së programit tonë modest mysafirët u shërbyen me një koktej rasti, dhe u paraqit ekspozita me punimet artistike të punuara nga nxënëset e Medresesë. Kështu, edhe mbaroi 1 Nëntori, ditë e veçantë dhe gjithmonë e shënuar në kalendarët tanë.

Diellza Kryeziu 12/4

MIRËSEARDHJE MEDRESISTËVE TË RINJ

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2016-2017, për hir të medresistëve të rinj, përkatësisht klasave të dhjeta, në amfiteatrin e Medresesë u



zhvillua takim mirëseardhës. Atyre me një fjalë rasti iu drejtua drejtori Mr. Jakup Çunaku, i cili i informoi me rregullat e shkollës sonë dhe, ndër të tjera, tha: "Jeni me fat të madh që tanimë jeni pjesë e kësaj shkolle, pasi bëheni komplet pjesë e kësaj vatre ku pajiseni me moral, edukatë, mësim dhe mirësjellje të duhur."

Ibrahim Lohaj 12/2

AKTIVITET MBI HIXHRETIN

Pas gatinjë dekade u risoll drama "Preokupimet", por tani në amfiteatrin e Medresesë. Ajo u shfaq në amfiteatrin e Medresesë "Alauddin" nga një grup i nxënësve të shkollave të ndryshme, e që njihen ndryshe si "Grupi Ardhmëria", që funksionon në udhëheqjen e hoxhës së nderuar Refik Gërbeshi.



Në këtë dramë u shfaqën plot mesazhe të ndryshme, herë në mënyrë komike e herë dramatike, që tërthorazi shprehnin problemet me të cilat ballafaqohen të rinjtë myslimanë të ditëve tona.

I pranishëm në këtë program ishte edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, i cili të pranishmëve iu drejtua me një fjalë rasti, për t'u pasuar nga drejtori i Medresesë "Alauddin", Jakup ef. Çunaku. E tëra kjo u organizua për nder të Vitit të Ri Hixhri, që u shënua po në atë ditë. Për nder të kësaj feste edhe nxënësit e Medresesë kishin përgatitur recital, si nga djemtë ashtu edhe nga vajzat, si dhe ilahi nga kori i shkollës.

Gjyltene Mavriqi 12/3

UDHËTIMI NË TURQI

Një nga shkollat më me famë në Republikën e Turqisë, "Imam Hatip Lisesi", çdo vit organizohet panairi shkencor për shkollat e ndryshme. Edhe këtë vit (2016) u mbajt i njëjti organizim, me ç'rast të ftuar si mysafirë nderi ishim edhe ne, Medreseja Alauddin.

Pasi u bë përzgjedhja e nxënësve dhe u caktua data e udhëtimit, u përzgjodhën edhe ata që do të na shoqërojnë në këtë udhëtim. Me ne ishin profesorët tanë të nderuar, të cilët me të vërtetë me kujdesin, modestinë dhe afërsinë na dhanë modelin më të mirë të edukatës dhe formimit që duhet ta synojmë.

Prof. Hysni Beka dhe prof. Ymridin Trishnjaku ishin me të vërtetë një përzgjedhje ideale për këtë udhëtim.

U nisëm, me ndihmën e Zotit, dhe porsa arritëm në Stamboll, atje gjetëm nikoqirin që kishte dalë të na presë, dhe prej atij momenti e deri në kthim ishim me të vërtetë dëshmitarë të një mik-



pritjeje që tejkalon mundësitë e përshkrimit më fjalë. Kishin menduar për çdo gjë, duke filluar nga pjesa që kishte të bënte me panairin, daljet dhe shëtitjet, drekat e darkat, e deri te akomodimi i rehatshëm në dhomat e pastra e të rregulluara bukur.

Sa i përket aktiviteteve të ndërlidhura me panairin, ato ishin të llojllojshme. Patëm rastin të marrim mësime në gjuhën angleze për lëndë të ndryshme shkencore, e të cilat përcilleshin me prova dhe eksperimentet e ndryshme, ku përfituam dije dhe përvoja të rëndësishme.

Më pastaj ishim të ndarë sipas lënëve përkatëse. Secili prej nesh merrte pjesë në lëmin të cilin kishte shkuar ta përfaqësonte. Aty patëm rastin që t'i prezantojmë njohuritë dhe përvojat tona modeste, me ç'rast morëm lëvdata dhe mirënjohje prej organizatorëve. Madje, ne si përfaqësues të Medresesë në këtë panair u dekoruam si më të suksesshmit.

Morëm premtime se ky organizim do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pra bashkëpunimi mes shkollave dhe shkëmbimi i përvojave të ndërsjella.

Mësuam, përfituam, e madje edhe u argëtuam. Por, ajo që na bëri të lumtur më së shumti ishte pjesa kur ne dëshmonim seriozitetin e shkollës tonë dhe kualitetin e mësimit që e marrim këtu.

Përshtypjet e mira që kanë të tjerët për ne na bëjnë të jemi më të përgjegjshëm dhe me vullnet dhe ambicie edhe më të madhe, që të synojmë majat e suksesit. */ Abdurrahman Rama 11/3*

DIJETARI ISLAM, DR. SELMAN EL AVDE, VIZITOI MEDRESENË

Në kuadër të vizitës së tij në Kosovë, dijetari me renome botërore nga Arabia Saudite, Dr. Selman El Avde, vizitoi edhe Medresenë e Mesme "Alauddin" në Prishtinë. Me këtë rast ai u prit nga drejtori i Medresesë, Mr. Jakup Çunaku dhe stafi edukativ-arsimor. Ndër të tjera ai shprehu konsideratën e tij mbi rolin e Medresesë përgjatë historisë, pra në edukimin e brezave, sidomos të përgatitjes së thirrësve islamë në trojet shqiptare. Ai shfrytëzoi rastin të bashkëbisedojë edhe me nxënës, të cilët patën kënaqësi të madhe pasi po e takonin njërin prej dijetarët më të mëdhenj të kohës sonë. Vizita e tij solli momente shumë të shkëlqyeshme. *Besart Thaçi 12/2*




GARAT E NXËNËSVE TË MEDRESESË NË BQK

Banka Qendrore e Kosovës, në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, në kuadër të aktivitetit për edukim financiar me moton "Edukim financiar për vendime të duhura", kanë shënuar Ditën Ndërkombëtare të Kursimeve. Ky aktivitet u shënua me një kuiz diturie, ku morën pjesë nxënësit nga shkollat e mesme të kryeqytetit. Ky kuiz u ndoq edhe nga nxënësit e Medresesë "Alauddin", ani pse në kuadër të plan-programit shkollor të Medresesë nuk gjendet ndonjë lëndë që ka lidhje me Ekonominë apo Financat. Mirëpo, vullneti i fuqishëm i nxënësve të shkollës sonë bëri që në këtë garë, jo edhe të lehtë, dhe në saje të njohurive të fituara për një kohë të shkurtër, nxënësit ta zënë vendin e dytë, dhe atë me shumë pak dallim nga Gjimnazi "Xhevdet Doda", i cili zuri vendin e parë. E rëndësishme të përmendet është se në këtë garë u krijuan hapësira bashkëpunimi me BQK-në dhe shoqërim me nxënës nga shkollat e tjera, para të cilave Medreseja u prezantua në mënyrë të dinjitetshme. */ Jetlira Ramadani 12/3*



DUHANI

Në vazhdën e aktiviteteve që këtë vit i organizoi Drejtoria e shkollës sonë, ishte edhe një program i shfaqur më datë 03.10.2016. Shkolla jonë kishte ftuar Prof. Dr. Ali Iljazin, që të flasë për një temë tejet të rëndësishme, e cila kishte të bënte me duhanin si dukuri negative, dhe dëmet e tij. Kjo dukuri, për fat të keq ka prekur shumicën e popullatës sonë, e në veçanti rininë tonë. Programi zgjati rreth një orë, e Dr. Ali Iljazi, nëpërmjet disa slajdeve na bëri të ditur shumë gjëra in-



teresante për duhanin, si nga ana e dëmit që e përmban, e po ashtu edhe nga ato që s'i kishim ditur, pra shumë kuriozitete të ndryshme. Po ashtu, edhe nxënësit kishin përgatitur disa slajde e video, të cilat ishin tejet të bukura dhe me përmbajtje dhe me mesazh.

Nxënësit pas programit nxënësit ishin pajisur me dituri që u mjaftonte të kuptonin se duhani është diçka e dëmshme, dhe se konsumimi i tij çon në shkatërrim. */ Mendim Sllamniku 12/1*

MBRETËRESHA MATEMATIKË

Meqenëse Matematika është quajtur mbretëresha e shkencave ekzakte, nxënëset e shkollës tonë mbajtën një program në lidhje me të. Fillimisht kjo ditë u hap me lexim Kurani, për t'i lënë hapsirë punimeve të paraqitura nga nxënëset, që kryesisht kishin të bëjnë me Teoremën e Pitagorës, mrekullitë shkencore të përmenduara në Kuran, si dhe lidhshmërinë e Matematikës me fushat tjera. Gjatë këtij programi u zhvillua edhe një lojë me publikun. Madje, vlen të për-



mendet se në këtë program ishin të pranishëm edhe nxënës nga shkollat e tjera. Krahas kësaj, ajo që e shtoi hijeshinë e këtij programi ishin punimet artistike të nxënëses Manushaqe Mehani. Ndërsa, ne shpresojmë që programe të tilla të dobishme të vazhdojnë të mbahen edhe më shumë në shkollën tonë. */ Medina Sherifi 12/4*

TURNIRI NË FUTBOLL

Edhe këtë vit shkolla jonë, përveç aktiviteteve të tjera, organizoi edhe turnirin në futboll. Këtij turniri hijeshi i dhanë nxënësit me pjesëmarrjen e tyre, e për dallim nga turnirët e zhvilluar deri më tani, seriozitet dhe vëmendje më të madhe i dha vetë drejtori i Medresesë, Jakup ef. Çunaku, i cili edhe bëri pjesën hapëse, duke na uruar fat gjatë kësaj ngjarje.

Në një atmosferë të bukur e të krijuar nga nxënësit filluan të zhvillohen ndeshjet, të cilat edhe ishin të parapara. Shorti ishte si në vijim:

12/2 (e2) vs 11/1 (e2) = 0 : 4
11/1 (e1) vs 10/1 (e1) = 1 : 0
10/2 (e1) vs 12/2 (e1) = 0 : 1
10/1 (e2) vs 12/1 (e1) = 0 : 3
11/3 (e1) vs 10/2 (e2) = 1 : 1 pas penaltive (6 : 5) ,

Ndërsa pas zhvillimit të lojërave të tjera, në gjysmëfinale shkuan këto ekipe:

11/1 (e1) pa lojë
11 /1 (e2) vs 12/1 (e1) = 0 : 1
12/2 (e1) vs 11/3 (e1) = 0 : 0

Pas lojërave të bukura që u zhvilluan, në finale shkuan 12/2 (e1) : 11/3 (e1), lojë kjo që u zhvillua ditën e enjte, në një mot shumë të mirë dhe atmosferë impozante e të shoqëruar edhe me praninë e drejtorit dhe profesorëve tanë të dashur.

Loja përfundoi 4 : 1, në favor të 12/2, e golat u shënuan nga: Benjamin Tahiri, Besart Thaçi (2) dhe Emir Latifi, ndërsa për klasën 11/3 shënoi Dardan Llapashtica.



Për ta bërë më të veçantë këtë aktivitet, aty për aty u nda edhe kupa për ekipin fitues, të cilën drejtori ia dhuroi Besart Thaçit, që njëkohësisht ishte edhe lojtari më i dalluar i turnirit, si dhe me më së shumti gola, i ndjekur pas nga Benjamin Tahiri.

Falënderojmë të gjithë për mbështetjen që na kanë dhënë, e gjithashtu falënderim i veçante shkon edhe për profesorin Shemsi Rrahimi dhe profesorin Hysni Beka, të cilët kanë ndarë kohë për të referuar ndeshjet. Shpresojmë që ky të jetë vetëm njëri ndër aktivitetet e shumta që do t'i mbajmë gjatë këtij viti shkollor!

Benjamin Tahiri 12/2

NDESHJE MIQËSORE E FUTBOLLIT



Me ftesën e shkollës "Prishtina High School", ekipi i futbollit i shkollës sonë ka zhvilluar një ndeshje miqësore, qëllimi i së cilës ndeshje ishte njohja e nxënësve ndërmjet vete. Ndeshja ishte e karakterizuar me një lojë korrekte dhe të matur nga të dy ekipet, ndërsa në fund fituese doli shkolla jonë .

-Falënderojmë djemtë për mundin dhe gatishmërinë e tyre, si dhe për paraqitjen dinjitoze që i bënë shkollës sonë! Gjithashtu një falënderim shkon edhe për shkollën nikoqire, e cila pas ndeshjes na dhuroi edhe 40 tekste shkollore në gjuhën angleze.

Rezultati nga ky takim ishte: "Prishtina High School" – "Medreseja Alauddin" = 8 : 11

Emir Latifi

NOTI – AKTIVITET I RI PËR MEDRESISTËT

E mërkura e datës 12.10.2016 ishte më e dalluar për medresistët që qenë në ambientet e shkollës së notit "Zenit". Aty medresistët filluan të bëjnë not, në një ambient fantastik dhe të ngrohtë, ku njeriu e largon lodhjen nga trupi i



tij . Për medresitët është një gjë shumë pozitive, sepse kohën e lirë nuk do ta humbasin kot, por do ta shfrytëzojnë në një sport shumë të mirë, siç është noti. Gjatë notit nxënësit do të jenë nën përkujdesjen e edukatorit dhe zhytësve që janë në shkollë. Përveç notit që do e bëjnë, nxënësit do t'i ushtrojnë edhe stilet e notit. Këtë herë në shkollën e notit shkuan vetëm disa nga nxënësit e dalluar, por nga muaji nëntor do të shkojnë të gjithë ata që janë të interesuar. /*Mustafë Dallku 11/2*

GARAT E VOLEJBOLLIT NË MEDRESE

Ditën e enjte, më 03.11.2016 nga paralelja e vajzave u organizua aktiviteti sportiv i volejbollit. Pas mësimit të gjitha nxënëset ia mësynë sallës sportive. Nuk munguan emocionet dhe brohoritjet e duartrokitjet. Hedhja e shortit u bë në mënyrë të drejtë, dhe sipas tij edhe u caktuan ndeshjet. Ndeshja e parë u zhvillua nga klasat e 20/3 dhe 10/4. Ndeshja e dytë u zhvillua mes 11/5 dhe 12/3, ndërsa loja e tretë mes klasave 11/4 dhe 12/4. Në finale shkuan klasat 12/4 dhe 11/5, e klasa kampione u zgjedh e 11/5.

Gresa Hyseni 12/4

GJËEGJËZAT

1. Çfarë vjen një herë në minutë, dy herë në moment, por asnjëherë në njëqind vjet?
2. Ti je zgjuar në ora 6 të mëngjesit, nga një trokitje në derën tënde. Prindërit tu të thërrasin që të ta bëjnë me dije se ata janë aty për mëngjes. Ti je i hutuar, por shpejt mendon se çfarë ushqimi ke. Ti ke djathë, bukë, marmelatë dhe vezë. Çka hap së pari?
3. Pa marrë parasysh sa të tmerrshme bëhen gjërat për njerëzit e Arktikut, ata nuk do të hanë as një pinguin. Pse jo?
4. Një vozitës autobusi ka kaluar shenjën STOP pa u ndalur, është kthyer majtas, aty ku ka qenë e ndaluar, dhe ka kaluar në krahun e gabuar, në një rrugë njëkahshe. Por, ai nuk ka thyer asnjë rregull. Pse?

Shpëtime Zekolli 11/4)



(Zgjidhjet):

1. Shkronja „M".
2. I ke hapur syrë.
3. Pinguinët nuk jetojnë në Arktik por në Antarktik.
4. Ai ka ecur






KURIOZITETE

- Në Skoci lindin më shumë flokëkuq sesa në krejt pjesën tjetër të botës.
- Krokodili nuk e nxjerr dot jashtë gjuhën e vet.



- Mbi 350 milionë njerëz vuajnë nga varësia ndaj Facebook-ut
- Një bllok ari i pastër, me madhësinë e një shkrepëseje, mund të shtrohet mbi një sipërfaqe sa një fushë tenisi.
- Në dhjetë minuta një uragan lëshon më shumë energji sesa të gjitha armët bërthamore së bashku.





- Rafflesiaarnoldi është lulja më e madhe në botë, dhe mund të rritet sa një ombrellë.



- Në Singapor është e jashtëligjshme të shesësh apo të mbash çamçakëz.
- Nga të gjitha shqisat, nuhatja është e lidhur më ngushtë me kujtesën.
- Femrat e kanë nuhatjen më të mirë sesa meshkujt.
- Chanel Tapper, student në Kaliforni, ka gjuhën më të gjatë në botë, pra 9.75 cm.
- Në Zelandën e Re jetojnë pak më tepër se 4 milionë njerëz, dhe mbi 70 milionë dele.



Omer Vehapi 12/2

KURIOZITETE

1. Peshku trashanik "Siluris Glanis"-shkencëtarët erdhën në përfundim se, përkundër kokës se madhe, është peshku më budalla në botë. Kjo sepse në pranverë, kur bën nxehtë, në breg të lumit rriten shelgjet, dhe në ujë bien thuprat e këtij druri së bashku me gjethet, e peshku trashanik me ngutësi i përpin, duke menduar se po bie ushqimi i tyre i preferuar. Në lukth këto fije të shelgjeve lëshojnë alkool, që e bën peshkun më "të humbur".





2. Malet më të larta në Ballkan janë Alpet Shqiptare, dhe kanë 13 maje, me mbi 2.500 metra lartësi, si dhe sipërfaqe 2.240 km^2.


3. Në trupin e njeriut ka rreth 656 muskuj. Disa prej tyre janë 38 cm, e disa mezi arrijnë një milimetër.



4. Gjaku në organizmin e njeriut udhëton shumë shpejt: nga zemra e deri te gishtërinjtë e këmbës arrin për 16 sekonda, deri në tru për 8 sekonda, e deri në mushkri vetëm për 6 sekonda.

5. Xhejson Pitri, nga Mexburgu (ShBA), për 13 vjet nuk bëri asnjë mungesë në shkollë.

6. Tomas Jang, fizikan nga shekulli XVIII-të, fliste dymbëdhjetë gjuhë kur i kishte vetëm tetë vjet.



7. Gjatë ndërtimit te kanalit të Panamasë kanë humbur jetën më tepër se 25 mijë njerëz.

8. Femrat qajnë mesatarisht nga 30 deri në 64 herë në vit, ndërsa meshkujt 6 deri në 17 herë.

9. Gjatë jetës së tij një mashkull harxhon pothuajse gjashtë muaj për të rruar mjekrën.

10. Femrat harxhojnë pothuajse një vit nga jeta e tyre për të vendosur se çfarë do të veshin.

Meriton Tërmkolli 12/2

SINQERITETI

Pse unë jam i sinqertë
Ty çka po të pengon
Ndaj teje sillem mirë
Kjo ty pse të mundon

Mundohesh të më ulësh
E të më ofendosh
Tek unë sinqeriteti plot
Por te ti qenka bosh

Unë të flas me paqe
E ti vazhdimisht më poshtëron
Se një ditë do të japësh llogari
Fare nuk po e mendon?

Deri kur do të vazhdosh
Me gënjeshtra e trillime
Frikësohu prej epsheve tua
E jo prej fesë time

Nehat Shehu 12/1

ËNDRRAT THËRRASIN

Atje ka lumturi të pafundme,
Këtu s'mund ta përjetosh,
Atje ka jetë të ëmbël,
Këtu s'mund ta jetosh.

Ëndrrat thërrasin,
Si s'mund të shkosh?
Ato flasin, por ti ende,
Këtu mund të qëndrosh.

S'do të shkoj. Unë këtë jetë që kam,
Në tokë do ta jetoj.
Ëndrrat janë mbi re,
Unë s'mund të fluturoj.

Firdevse Sylejmani: 11/4

ZGJOHU!

Zgjohu! Shiko dielli ka lindur!
Një ditë e mirë ka aguar për ty.
Ngrihu! Shiko dhe Zotin tënd, falëndero!
Të ngjalli për ta lutur Atë, prandaj lute!
Të dha edhe një ditë, që do të dësh-
mojë për ty, ose kundër teje.

Tash, menjëherë ngrihu, e mos u hamend!
Pastrohu, dhe Zotin tënd lute e madhëroje!
Ke sy të shikosh. Kujtoje sa njerëz nuk i kanë!
Ke duar, këmbë. Falënde-
ro, o rob i Atij që t'i dha!
Pse nuk frikësohesh se një
ditë mund të t'i marrë?

Një ditë emri yt do të harrohet, e
nuk do të të përmend askush.
E dhembshme, apo jo?!
Ti do të jesh vetëm kujtim i njerëzve.
Prandaj, bëhu kujtim i mirë për ta!
Ty po ta them.
Sepse ti je i vlefshëm.

Ty, që zgjodhe rininë tënde si ta kalosh.
Duke e lutur e madhëruar Krijuesin tënd.
Zgjohu! Se zemrën tende e ka ka-
pluar hija e dynjasë.
Zgjohu! Edhe për ty ka shprese
sepse nuk je i vetmi.
Zgjohu! Dhe lutu, se do të jesh i shpëtuar.

Faik Llumnica 12/1

Fjalëtërthore


A	L	F	U	K	U	R	A	N	I	T	I	A	LL	A	H
S	R	C	U	B	A	K	A	I	D	I	F	G	P	E	T
T	G	SH	L	M	F	A	O	T	S	K	ZH	I	L	K	F
R	I	X	A	A	DH	L	G	I	E	U	K	S	K	A	U
K	Z	D	O	T	E	A	N	B	P	V	L	A	U	H	I
H	E	J	Y	E	V	U	S	SH	E	O	R	C	R	K	E
U	B	F	E	M	E	D	R	E	S	E	J	A	K	E	N
O	U	H	I	A	RR	D	ZH	E	K	XH	A	K	T	C	O
D	R	L	V	T	O	I	T	Y	B	F	L	U	S	I	L
F	I	U	F	I	R	N	L	A	XH	L	A	H	L	A	K
V	B	R	T	K	C	Ç	X	O	N	E	G	N	E	M	I
N	D	K	V	Ë	K	X	T	E	F	S	I	R	C	R	N

Granit Arifaj 10/2

7	8		4			1	2	
6				7	5			9
			6		1		7	8
		7		4		2	6	
		1		5		9	3	
9		4		6				5
	7		3				1	2
1	2				7	4		
	4	9	2		6			7

				7			6	
2								
	9			5				
						1		
		4						
					3	8		

Shpetime Zekolli 11/5



Rudina Tovërlani 12/3
punim grafik "mandalla"